



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1340/3 prot.

Tiranë, më 25.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 1340/1, DATË 15.05.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË PRAKTIKËS SË PËRCJELLË NGA ISH KLD, PËR ANKESAT E BASHKUARA TË SHTETASIT Z. MARJAN NIKOLLA"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e z. Marjan Nikolla regjistruar me nr. 2823 prot., datë 23.11.2020, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. A.S., gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe me vendimin nr. 1340/1, datë 15.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas verifikimit të praktikës së përcjellë nga ish KLD, për ankesat e bashkuara të shtetasit z. Marjan Nikolla", bazuar në nenet 117, 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, Policisë së Shtetit, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

